



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.111/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Therandë, për shkak të vendosjes së postierit në objekt publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR, dega në Therandë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,300.00 (dymijetreqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 06.06.2017 nga Lëvizjes Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017, ka vërejtur se të shtëpia e Kulturës në Therandë është vendosur postieri kandidates për deputete Albena Reshitaj, nga Koalicioni LDK-AKR, i cili ishte vërejtur nga aktivisti Fisnik Shala, diku rreth orës 15:00. Për këtë ne kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pikës (b) Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në pronë publike dhe hapësira, përbën veprim të ndaluar për subjektin politik, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj koalicioni me vendosjen e postierit të kandidatit të saj në vend publik, konkretisht në murin e shtëpisë së Kulturës në Therandë, ka bërë shkelje të dispozitave se nenit 4.1 pikës (b) të Rregullores Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2(dy) fotografimin të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni LDK-AKR, të datës 07.06.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se e kemi urdhëruar kandidatin që të ndër marr veprime përmirësuese, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarr masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur 1(një) foto nga vendi ku janë larguar posterat. PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit e kandidatës për deputete nga radhët e koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në objektin publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkëlur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterit e kandidatës për deputete nga koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në objektin publik. Të njëjtën shkëlje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja nga ana e këtij koalicioni është përsëritur shumë herë nga ana e tyre në këtë proces zgjedhor, ku edhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatës për deputete nga koalicioni LDK-AKR, janë vendosur në objektin publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar, kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posterat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

Anr. 111/2017 më datën 07.06.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haxiri**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***